

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ILVA H. DACI
ADRESA Rr: "Faik Konica", Ndertesa
nr.6, shk.5, kt.4, Ap.12, Tirane
TEL: 672044805

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 838

Nr. koleksioni: 120

Tirane më 08/08/2023


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023050650012592986



A2023050650012592956

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "VIAJES ALBANIA " SH.P.K)

Sot, më, datë 08.08.2023 , para meje Notere ILVA H. DACI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr: "Faik Konica", Ndertesa nr.6, shk.5, kt.4, Ap.12, Tirane, u paraqit personalisht:

SHITES:

Hasmi Hidri, atësia Sefer, amësia Hanke, shtetas Shqiptar, lindur në Petrelë, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Stërmas; Nd. 002; Petrelë; Stërmas; 1034; Tiranë, lindur më 21/09/1962, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034788889 dhe nr. personal G20921026S, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë VIAJES ALBANIA, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M31906004O, datë 06.07.2023; me seli në Tiranë, me adresë Tirane Tirane Tirane, Selite, Zona Kadastrale 3292 Nr I Pasurise 153/116+3-6 Vol 25 Faqe 149, zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë prej 100 lek (njëqind lekë),

BLERES:

OLIVA CARRASCO TORIBIO, atësia EMILIANO, amësia Julia shtetase Spanjolle, lindur në AVILA dhe banuese Selite, Tirane, lindur më 29/06/1981, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. PAN579438 dhe nr. leternjoftimi shqiptar I18629001M, e cila deklaroi se nuk e njeh gjuhën shqipe e për pasojë bazuar në ligjin 110/2018 " Per Noterine " , i ndryshuar komunikimi u bë në gjuhën spanjolle nga unë noteri.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligji 10428 date 02.06.2011 " Per te Drejten Nderkombetare Private" bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë " Viajes Iliria " Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

MEQENËSE:

- Shitësi zoteron 100% (njëqind për qind të kuotave) në kapitalin e shoqërisë "Viajes Albania" sh.p.k, themeluar më datë 30.06.2023 dhe regjistruar me date 06.07.2023, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të biznesit NUIS, me NIPT M31906004O , me seli në Tiranë, me adresë Tirane Tirane Tirane, Selite, Zona Kadastrale 3292 Nr I Pasurise 153/116+3-6 Vol 25 Faqe 149, kuotë që ka një vlerë nominale prej 100 lekë (njëqind leke) dhe i jep të drejta të plota vote sipas legjislacionit shqiptar; (në vijim referuar si "Shoqëria");
- Shitësi shpreh vullnetin e tij duke pranuar t'i shitet kuota të tij në Shoqëri me një vlerë nominale 100 lekë (njëqind leke) që përbejnë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi pranon dhe merr përsipër të blejë kuotën e lartpërmendur nga Shitësi;



A2023050650012392986

d. Palët zgjedhin që të aplikohet legjislacioni shqiptar në lidhje me këto kontrate.

Palët bien dakord për sa vijon:



Neni 1 Objekti i Kontratës

- a. Përmes kësaj kontrate, Shitësi Z. Hasmi Hidri transferon tek Blerësi Oliva Carrasco Toribio, përmes shitjes, 100% (njëqind për qind) të kuotave së kapitalit të Shoqërisë "Viajes Albania" sh.p.k, me vlerën e saj nominale prej 100 lek (njëqind lek) ALL.
- b. Blerësi deklaron se pranon të blejë 100% të kuotave të zotëruara nga Z.Hasmi Hidri.
- c. Kuota do të transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe Blerësi do të bëhet ortak i vetëm me të drejta të plota me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, me të drejtë vote të ligjshme, dhe pranon të gjitha të drejtave dhe detyrimet të lidhura me kuotën e blerë, dhe të të gjitha përfitimeve në masën e kuotës bazuar në dispozitat e Statutit të Shoqërisë.
- d. Transferimi, përmes shitjes së kuotës, do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, mbi të gjitha, me dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe Ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Neni 2 Çmimi dhe mënyra e pagesës

- a. Transferimi i kuotës së kapitalit të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi, bazuar në Nenin 1 të kësaj kontrate, është i barabartë me vlerën e saj nominale dhe palët bien dakord që ky çmim të përfshihet në shumën totale do të bëhet duke paguar vlerën prej 100 lek (njëqind) ALL kundrejt Shitësit Z. Hasmi Hidri
- b. Palët pranojnë që çmimi i shitjes është paguar dhe Shitësi nuk ka ndonjë pretendim financiar ndaj blerësit as tani, as në të ardhmen.

Neni 3 Të drejtat, deklaratat dhe garancitë e palëve


a. Garancitë e Shitësit

Shitësi nëpërmjet kësaj kontrate i deklaron dhe i garanton blerësit që:

- i. Shitësi ka aftësi të plotë ligjore për të vepruar dhe ka të gjitha fuqitë në lidhje me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate, si dhe për ekzekutimin e transaksionit të përcaktuar nga kjo e fundit; dhe
- ii. Shitësi është mbajtësi i kuotës pa asnjë kredi, hipotekë, komision sigurie, peng, marrëveshje kufizuese, kufizim i transferimit ose kufizim të së drejtës së votës ose ndonjë mjet tjetër juridik që ti kufizojë të drejtën e pronës mbi kuotat.

b. Garancitë e Blerësit

- i. Blerësi deklaron dhe pajtohet të ketë marrë informacion të mjaftueshëm në lidhje me Shoqërinë "Viajes Albania" sh.p.k, dhe se nuk ka asnjë deklaratë të veçantë për të kryer mbi gjendjen e tij faktike ligjore ose financiare dhe/ose procesin e vendimmarrjes për politikë ekonomike dhe/ose ndonjë natyrë tjetër që lidhet me biznesin e shoqërisë.



A2023050650012392986

Neni 4 Struktura e Shoqërisë pas Shitjes së Kuotës

- a. Pas shitjes së kuotës, Shoqëria do të ketë strukturën siç vijon:
Ortaku: Oliva Carrasco Toribio, do të mbajë 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme prej 100 ALL (njëqind), e cila do të përbëjë **100% (njëqind për qind)** të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 5 Forca Madhore

- a. Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet si përgjegjëse në rast se përmbushja e ndonjë dispozite të kësaj kontrate vonohet ose ndalohet për shkak të forcës madhore dhe, mbi të gjitha, si rezultat i revolucioneve, çrregullimeve, trazirave, luftërave, goditjeve, zjarreve, përmbytjeve, tërmeteve, fenomene të natyrës, shtetëzim, shpronësim ose akte të pushtetit qendror lokal që kufizojnë lirinë personale ose atë të Shoqërisë.

Neni 6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- a. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhet nga Palët me mirëkuptimin e duhur. Palët e kësaj Kontrate do të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme dhe të arsyeshme për të zgjidhur në mirëbesim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga kjo e fundit ose në çfarëdo mënyre lidhur me këtë kontratë (përfshirë formulimin e kësaj Kontrate dhe çështjet e lidhura me të) vlefshmërinë, interpretimin, performancën, shkeljen ose përfundimin e kësaj Kontrate dhe ndreqjen ose pasojat e pavlefshmërisë së tij.
- b. Nëse Palët nuk janë në gjendje të zgjidhin në mënyrë miqësore mosmarrëveshjet që lindin midis tyre në pajtim me paragrafin e mëparshëm, Palët do t'i referohen Gjyqates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7 Të ndryshme

- a. Kjo Kontratë zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- b. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të Palëve si dhe deklaratimet e plota dhe ekskluzive të kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë në lidhje me objektin e saj. Kjo Kontratë zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo mirëkuptimet e mëparshme, me shkrim apo me gojë, që mund të ekzistojnë midis Palëve lidhur me objektin e kësaj Kontrate, apo pjese të saj.
- c. Nëse secila prej dispozitave të kësaj Kontrate është apo do të bëhet e pavlefshme, pjesërisht apo tërësisht, vlefshmëria dhe legjitimiteti i dispozitave të tjera mbetet e pacenuar. Dispozitat e pavlefshme, në masën e lejuar me ligj, do të zëvendësohen me dispozita të tjera të vlefshme dhe të zbatueshme të cilat duhet të jenë në përputhje me synimin dhe qëllimin ekonomik të dispozitave që zëvendësojnë, të cilat janë të pavlefshme e të pazbatueshme.
- d. Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila. Nga një kopje i jepet secilës Palë, një kopje ruhet pranë arkivit të Shoqërisë dhe një depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe transferimin e pronësive mbi kuotat
- e. Çdo ndryshim i bërë në kontekstin e kësaj kontrate duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga Palët.
- f. Kostot dhe shpenzimet për regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbulohen nga Blerësi.
- g. Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe është e vlefshme që nga momenti kur nënshkruhet nga Palët.



A2023050650012392986

Neni 8

Anekset e Kontratës

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës:

Vendimi i Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë "Viajes Albania" datë 06.08.2023

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "Viajes Albania" Sh.p.k..
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 9

Dispozitat Përfundimtare

a. Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese me perkthim në gjuhën spanjolle, dhe pasi më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj, dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

b. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Kjo kontrate hartohet në 4 (tre) kopje në gjuhën shqipe nga të cilat tre për palët dhe një kopje për arkivën noteriale

c. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Hasmi Hidri

BLERES

Olivia Carrasco Toribio

OLIVIA CARRASCO TORIBIO

Noter

ILVA H. DACI

